

Evaluimi i bazës së të dhënave të Librit të Kujtimit të Kosovës

10 Dhjetor, 2014

Dr Patrick Ball dhe dr Jule Krüger, Human Rights Data Analysis Group

Raport „Evaluimi i bazës së të dhënave të Librit të Kujtimit të Kosovës“,

Konkluzione dhe rekomandime

„Përfundimi më i rëndësishëm i analizës sonë është se Baza e të Dhënave të Librit të Kujtimit të Kosovës dokumenton të gjitha ose pothuajse të gjitha humbjet njerëzore gjatë konfliktit në Kosovë gjatë periudhës 1998 -2000. Me shprehjen „pothuajse të gjitha - nearly all," ne nënkuptojmë se, sipas mendimit tonë, sipas të gjitha gjasave ekzistojnë pak më shumë se disa dhjetëra raste të vdekjeve të padokumentuara. Ky përfundim bazohet në disa analiza dhe gjetje, duke e përfshirë këtu edhe krahasimin me dhjetë baza të tjera të të dhënave, në të cilat nuk janë gjetur të dhëna të reja; në analizën statistikore, në të cilën është gjetur se LKVK ka më shumë shënime se sa cilado bazë e të dhënave në secilën periudhë dhe për secilën komunë; dhe në një analizë shoqërore të profesorit Michael Spagat, e cila tregon se LKK është në përputhje me vlerësimet e dy bazave të pavarura të probabilitetit të të gjitha humbjeve njerëzore.

Ne besojmë se ka një mësim më të madh në shënimet përfundimtare të “viktimave potenciale” në LKVK. Me gjithë punën e dhjetëra hulumtuesve dhe të analistëve, e cila shtrihet më shumë se një dhjetëvjetësh, me gjasë është e pamundshme për të krijuar një regjistër ekzakt, të saktë, i cili përfshin vetëm viktimat e vërteta të luftës dhe, në të njëjtën kohë, të gjitha viktimat e vërteta të luftës. Fondi i njohurive shoqërore mbi të kaluarën thjesht nuk mbulon secilën prej ngjarjeve, në të cilat viktimat kanë pësuar. Megjithatë, vërtet është e mundshme që të jemi shumë afër një regjistri të saktë.

Pasaktësitë e vogla në raportim nuk i pengojnë analizat tona të modeleve të mëdha të konfliktit. LKVK është një burim i pasur për kujtesën historike dhe reagimet e tjera të drejtësisë tranzicionale, për analizën statistikore të konfliktit dhe, më e rëndësishmja, për të qenë një regjistër i përherëshëm i emrave dhe i jetëve të viktimave të humbura në konflikt.

Rekomandime

Ne kemi një numër të vogël të rekomandimeve teknike për FDH dhe FDH-Kosovë:

- Ne rekomandojmë që stafi i LKK të dallojë të dhënat midis informacionit të munguar dhe ditës së parë të muajit dhe muajit të parë të vitit (shih Pjesët 4.7 dhe Pjesën 4.10). Ditët e munguara aktualisht janë të regjistruara si `1,' dhe muajt e munguar janë të regjistruar si `1.' Këto duhet të kenë ndonjë vlerë tjetër shënuese (p.sh., -1 ose NA).
- Informacioni mbi emrin duhet më tutje të standardizohet, siç është vërejtur në Pjesën 4.3.
- Fusha e tashme e etnicitetit duhet të ndahet në etnicitet dhe shtetësi, siç është vërejtur në Pjesën 4.6
- Ne rekomandojmë që personeli i LKK të shqyrtojë përcaktimin për shprehjen e viktimave “jo të luftës”, të cilat kanë vetëm një burim të dokumentimit kur viktimat nuk është gjetur

gjallë. Me gjasë, ato viktimat mund të mbahen në listën potenciale të viktimave derisa të ketë më shumë informacion në dispozicion, që i mundëson stafit për të vërtetuar ose mohuar ndërlidhjen me luftën në Kosovë.

- Të korrigjojë informacionin mbi datën e origjinës, të plotësojë informacionin e munguar në gjuhën e burimit. Shih Pjesën 5.2 për shumë diskutim.

Këto janë përmirësime relativisht të vogla dhe standardizime dhe ato do t'i kontribuojnë një baze pothuajse të shkëlqyeshme të të dhënave“.

Udhëzime për hulumtimin e ardhshëm

Ekzistojnë një numër interesant i udhëzimeve për një hulumtim të ardhshëm mundshëm për këtë projekt:

- Që sistematikisht të hulumtohet dhe të kodohen rrethanat e vdekjes. Baza e të dhënave aktualisht vetëm regjistron llojin e dhunës, pra, vdekjen ose zhdukjen. Një version i ardhshëm i të dhënave mund të sigurojë informacion sistematik mbi shkakun e vdekjes, siç është arma e përdorur.
- Të gjendet më shumë informacion mbi kryerësin e krimit, pra, në aspektin formacionit përgjegjës të armatosur të secilës vrasje (shih Tabelën 4.4), do të ishte jashtëzakonisht e dobishme për shfrytëzimin e ardhshëm të hulumtuesit të kësaj të dhëne, posaçërisht për qëllime të drejtësisë tranzicionale.
- Një fushë tjetër e ndërlidhur do të ishte që sistematikisht të dokumentohet lëvizja e forcave të armatosura dhe shfrytëzimi i sulmeve ajrore në konflikt.
- Të grupohen viktimat sipas ngjarjeve, duke i lidhur viktimat të cilat kanë vdekur dhe janë zhdukur brenda të njëjtës ngjarjeje, të hulumtohet numri i viktimave sipas ngjarjes. Krijimi i ngjarjeve do ta transformonte bazën e të dhënave nga një listë e viktimave në një narrativ të ngjarjeve, një hap përpara drejt një historie përfundimtare, të gjithmbarshme të konfliktit.
- Me një projekt shumë më të madh, të dokumentohen shkeljet jo-vdekjeprurëse, të cilat i kanë paraprirë shkeljeve vdekjeprurëse, duke përfshirë kërcënimet, burgosjet, torturën, abuzimet seksuale, shkatërrimin e pronës dhe shkeljet e tjera të të drejtave të njeriut. Këto shkelje do të kishin nevojë për të njëjtat hollësi lidhur me datën dhe vendin e shkeljes si dhe kryerësit e krimeve. Informacioni lidhur me shkeljet jo-vdekjeprurëse është një hap tjetër drejt një historie të gjithmbarshme të konfliktit dhe ai do t'iu mundësonte hulumtuesve për të kuptuar repertorin dhe trajektoren e dhunës.

Ne e përgëzojmë FDH dhe FDH-Kosovë për punën e jashtëzakonshme dhe projektin e shquar. Pak konflikteve iu është kushtuar vëmendje kaq e qëndrueshme dhe profesionale aq sa FDH dhe FDH Kosovë i ka kushtuar vëmendje humbjeve njerëzore në Kosovë në periudhën 1998-2000. Bota përfiton nga kjo njohuri. Mbi të gjitha, ne i pranojmë viktimat, të cilat tash do të kujtohen përgjithmonë.

Profesor Michael Spagat, Royal Holloway, Universiteti i Londrës

Raport “Një triumf i kujtesës: Libri i Kujtimit i Kosovës,, (A Triumph of Remembering: Kosovo Memory Book“),

Përfundim

„Forma e përgjithshme e serive të kohës së LKVK nuk do të ndryshonte substancialisht madje edhe nëse më shumë të dhëna vihen në dispozicion në të ardhmen dhe një numër i vdekjeve potenciale në të ardhmen transferohen nga lista e vdekjeve potenciale në listën e vdekjeve të vërteta. Shkurtimisht, LKVK i kalon të gjitha testet, të cilave ia nënshtrojmë unë.

Prapë, dokumenti i tashëm është vendosur brenda një tabloje më të gjerë të kualitetit dhe të konsistencës, një pjesë e madhe e të cilave janë dokumentuar në Raportin e Krügerit dhe të Ballit të vitit (2014) dhe shfaqur në Metodologjinë e Bazës së të Dhënave të Librit të Kujtimit (2014b) të Fondit për të Drejtën Humanitare dhe Fondit për të Drejtën Humanitare-Kosovë. Së bashku, këta tre dokumente sigurojnë një dëshmi të fuqishme të një cilësie të lartë dhe të karakterit pothuajse gjithëpërfshirës të bazës së të dhënave të LKB.

Është shumë e pazakonshme për një projekt, i cili dokumenton vdekjet e luftës mbi bazat e secilit rast të përparojë deri në pikën ku e arrin praktikisht secilin rast prej tyre. LKVK duket se e ka arritur këtë pikë, ndërsa në të njëjtën kohë siguron një shkallë fare të gjerë të informacionit të saktë për secilën viktimë.

Libri i Kujtimit i Kosovës është një e arritur e jashtëzakonshme, që qëndron si një monument, si për viktimat, ashtu edhe për shpirtin njerëzor.“